

14.02.2022

Ora 12:39

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim “Për pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 03, paraqitur në KQZ në datën 12.02.2022.**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Illirjan RUSMALI,  
Z.L.Braho.
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, E.Meta, E.Mema.
- **Parti politike** LRE


**Z. I. Rusmali:** Mirëdita! Fillojmë seancën për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 3, datë 12.02.2022, të paraqitur nga subjekti zgjedhor Lëvizja e Re, kundër vendimit nr.72, datë 12.02.2022 “Për shqyrtimin e kërkesës të subjektit zgjedhor Lëvizja e Re, për regjistrimin e kandidatit për kryetar në Bashkinë Durrës, zotin Jonid Robert Nano, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022. KAS-i është prezent në përbërje të plotë. Nga subjekti ankues janë paraqitur sot, ju lutem prezantohuni të tre.

**Znj. E. Nano, juriste e LRE-së:** Evisa Nano, juriste.

**Z. A. Galdini, kryetar i Partisë LRE-së:** Arian Galdini, kryetar i partisë.

**Z. J. Nano, kandidati për kryetar i Bashkisë Durrës:** Jani Nano, kandidati në fjalë.

**Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

*Dt.14.02.2022*

**Z. I. Rusmali:** Faleminderit! Gjithashtu janë prezent dhe si zakonisht përfaqësuesit e administratës, të kryesuar nga Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së. Përpara se të fillojmë trajtimin e çështjes që kemi sot, ne kemi shqyrtimin paraprak, ka ndonjë kërkesë në raport me përbërjen e KAS-it, ndonjë kundërshtim lidhur me anëtarësinë tonë këtu?

**Znj. E. Nano, juriste e LRE-së:** Jo!

**Z. I. Rusmali:** Nuk ka! Ju keni ndonjë deklaram për të bërë? Jo! Asgjë! Mirë atëherë, sipas procedurës që kemi ne, pjesën hyrëse e ka Sekretari i Përgjithshëm që të na fusë në temë, pastaj ju do të merrni fjalën për të trajtuar sot çështjen formale të kërkesës. Po, zoti Merkaj!

**Z. Y. Merkaj:** Pranë Komisionit Qendror të zgjedhjeve është depozituar kërkesa ankimore me nr. 3, në datë 12.02.2022, në orën 21:15. Me të marrë kërkesën ankimore është zhvilluar seanca e shortit sipas nenit 14 të Rregullores së KAS-it, ku në përfundim të procedurës së shortit u caktua si relator zoti Ilirjan Rusmali. Pasi kemi marrë kërkesën ankimore, kemi parë, kemi verifikuar paraprakisht kërkesën ankimore, e cila për mendimin tonë është në përputhje me nenin 126 të Kodit Zgjedhor, si nga forma ashtu dhe nga përmbajtja, pasi përmban emrin e subjektit ankues, referimin e vendimit që ankimohet, bazën ligjore, përshkrimin e shkurtër të shkeljes së pretenduar, si dhe përshkrimin e fakteve apo argumenteve, tek të cilat mbështetet ankimi. Gjithashtu është në përputhje dhe me nenin 130, të Kodit Zgjedhor. Objekti i verifikimit paraprak është kompetencë e KAS-it për vendimet që merr Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, legjitimimi i ankuesit që legjitimohet,

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.14.02.2022*

pasi ka interes të ligjshëm për çështjen, si dhe respektimi i afateve ligjore është bërë brenda afatit të përcaktuar në ligj.

**Z. I. Rusmali:** Faleminderit zoti Merkaj! Subjekti ankues, besoj, ju kërkoni që ne ta marrim në shqyrtim, ju nuk keni pretendime?

**Znj. E. Nano, juriste e LRE-së:** Po, patjetër! Të merret në shqyrtim!

**Z. I. Rusmali:** Lidhur me elementet e formës me kompetencën tonë përsa kohë që na keni angazhuar. Subjekte të interesuara nuk janë paraqitur për shqyrtimin e kësaj, të tjera subjekte. Kështu që s'kemi kë pyesim tjetër për këtë punë. Kolegët kanë ndonjë gjë për të thënë? Jo! Dhe siç e kuptoj unë, Komisioni është plotësisht dakord që ta marrë në shqyrtim sepse janë të gjitha kushtet sipas ligjit dhe shqyrtimin, trajtimin e çështjes në themel do ta zhvillojmë, në qoftë se nuk keni ndonjë kundërshtim ju si palë, nesër në orën 12:00, është në rregull për ju? Atëherë merret vendim që shqyrtimi i çështjes të bëhet nesër, në datën 15.02.2022, në orën 12:00. E mbyllim për sot shqyrtimin. Takohemi nesër sipas këtij orari. Faleminderit!

**Vendim nr. 7**

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*

